



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.03.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.02.2023, pas shqyrtimit të Propozimit, 128 të datës 07.02.2023, të paraqitur nga Kryetari i Komunës dhe i shqyrtuar në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 11, të Rregullores për ndarjen e subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

Për lejimin e shpenzimeve të mjeteve financiare nga kodi i participimit për subvencione në bujqësi për Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2023

1. Lejohet shpenzimi i mjeteve financiare në shumë prej 265,000.00€, prej 'Kodit të participimit, subvencioneve dhe transfereve', për ndihmë ekonomike familjare, duke e përfshirë edhe mbetjen e mjeteve financiare në shumën prej: 6,990€, nga participimi i fermerëve në vitin 2023, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2023 si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej: 30,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Serrave';
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej: 50,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Motokultivatorëve';
 - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej: 138,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Mekanizmit bujqësor';
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej: 15,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Pajisjeve bletare';
 - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej: 15,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Folive';
 - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej: 17,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e 'Plehut Azotik';
2. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga paragrafi 1, nënparagrafët prej 1.1 e deri tek nënparagrafin 1.4, të paragrafit një të vendimit, participojnë edhe fermerët e Komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2023, me 3% të vlerës së projekteve.

3. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës sipas pikës një (1) të vendimit dhe kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është kompetencë e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Bujqësisë e Zhvillimit Rural dhe Zyrës së Prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Ueb-faqen e Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORAT E ADMINISTRATËS

Nrfaq/Betr. 65
Data/Datum. 06 - 03 - 2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 03.03.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.02.2023, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 165, të datës 15.02.2023, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, nenin 40, paragrafi 40.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenin 12, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

**Për aprovimin e Nismës për realizimin e Bashkëpunimit Ndërkomunal me
Komunat e Regjionit të Prishtinës**

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 165, të datës 15.02.2023, për fillimin e konsultimeve në kuadër të Nismës për realizimin e Bashkëpunimit Ndërkomunal me Komunat e Regjionit të Prishtinës si vijon:
 - 1.1 Komunën e Prishtinës;
 - 1.2 Komunën e Fushë-Kosovës;
 - 1.3 Komunën e Obiliqit;
 - 1.4 Komunën e Lipjanit;
 - 1.5 Komunën e Podujevës dhe
 - 1.6 Komunën e Graçanicës.
2. Bashkëpunimi Ndërkomunal zhvillohet në fushat e përgjegjësisë të përbashkëta, për realizimin më të lehtë dhe efektiv të kompetencave vetanake të komunave.
3. Themelimi i Bashkëpunimit Ndërkomunal i Komunës së Fushë-Kosovës, me komunat tjera në fusha të ndryshme me interes të përgjithshëm publik, bëhet për ushtrimin efektiv të shërbimeve publike dhe ngritjes së mirëqenies së qytetarëve.
4. Kuvendi i Komunës me këtë vendim e delegon kompetencën e vetë dhe autorizon Kryetarin e Komunës së Fushë-Kosovës për të filluar konsultimet me komunat për përgatitjen e 'Propozim-Marrëveshjes për Bashkëpunimin Ndërkomunal me Komunat e Regjionit të Prishtinës'.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e Komunës sipas fushave përkatëse.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtortëve të Komunës dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.03.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.02.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 51, të datës 15.02.2023, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Kodit të Etikës

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Kodit të Etikës në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Fisnik Sllamniku - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.2 Laurat Gojnovci - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Doruntina Jashari - Përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.4 Migjen Kolshi - Përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.5 Hasan Ismajli - Përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
 - 1.6 Vlora Kurtaj - Zyrtare e Lartë e Personelit, anëtare;
 - 1.7 Miranda Sulejmani - Zyrtare Ligjore në Drejtorinë e Arsimit, anëtare;
 - 1.8 Ganimete Berisha - Zyrtare për Shëndetësi, anëtare;
 - 1.9 Ali Topalli - Udhëheqës i Sektorit për Kulturë Rini dhe Sport, anëtar;
 - 1.10 Veselin Petrovic - Zyrtar për Pronë, anëtar dhe
 - 1.11 Maliq Thaçi - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.
2. Në punën e Grupit Punues sipas detyrës do të marrin pjesë edhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Shefja e Zyrës Ligjore dhe Zyrtari i Lartë për Kuvend dhe Komitete.
3. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues, nga pika një (1) e vendimit, është hartimi i Projekt-Kodit të Etikës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE

MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.03.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.02.2023, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 138, të datës 15.02.2023, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Planit për Barazi Gjinore të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025

1. Për miratimin e Planit për Barazi Gjinore të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2023-2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani për Barazi Gjinore i Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, përgjegjës është Kryetari i Komunës, Drejtoritë e Komunës dhe Njësiti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.


Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtoritë e Komunës dhe Njësiti për të Drejtat e Njeriut e Barazi Gjinore dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.03.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.02.2023, pas shqyrtimit të Propozimit për rishqyrtimin e vendimit Nr. 284, të datës 29.12.2022, i paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-4/5, të datës 09.02.2023, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 284, të datës 29.12.2022 për fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim me qira të objekteve të Ambulancave të Mjekësisë Familjare

1. Për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 284, të datës 29.12.2022, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-4/5, të datës 09.02.2023, lidhur me Propozimin Nr. 1255, të datës 13.12.2022 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për dhënien në shfrytëzim me qira të objekteve të Ambulancave të Mjekësisë Familjare për periudhën njëvjeçare në fshatrat si vijon:
 - 1.1 Objekti shëndetësorë në Henc i ndërtuar në Ngastrën Kadastrale me Nr. P-72514031-00383-0;
 - 1.2 Objekti shëndetësorë në Bardh i Vogël i ndërtuar në Ngastrën Kadastrale me Nr. P-72514049-00197-0 dhe
 - 1.3 Objekti shëndetësorë në Grabovc i Poshtëm i ndërtuar në Ngastrën Kadastrale me Nr. P-72514028-00855-0.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHMS, Drejtorisë së GJKP dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT - DIREKTAJA ZA ADMINISTRACIJO
Nr.faq/Bc.shr. 69
Data/Datum. 06 03 -2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Datë: 03.03.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 27.02.2023, pas shqyrtimit të Propozimit me Nr. 138, të datës 15.02.2023, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (g, s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (e, n), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për Njësinë e Zjarrëfiksëve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për Njësinë e Zjarrëfiksëve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në fshatin Bardh i Vogël në këto ngastra kadastrale si vijon:
 - 1.1 Ngastra Kadastrale me Nr. P-72514049-00053-0, në sipërfaqe prej: S=110m², në vendin e quajtur 'Kod Dubova Qar', e evidentuar në certifikatën e pronës së datës 14.02.2023, në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël;
 - 1.2 Ngastra Kadastrale me Nr. P-72514049-00054-0, në sipërfaqe prej: S=693m², në vendin e quajtur 'Kod Dubova Ara Fushë', e evidentuar në certifikatën e pronës së datës 14.02.2023, në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël;
 - 1.3 Ngastra Kadastrale me Nr. P-72514049-00055-0, në sipërfaqe prej: S=2503m², në vendin e quajtur 'Kod Dubova Bataline', e evidentuar në certifikatën e pronës së datës 14.02.2023, në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës.
3. Objekti për Njësinë e Zjarrëfiksëve do të realizohet nga Agjensia për Menaxhimin e Emërgjencave, për të përmbushur nevojat e Komunës së Fushë-Kosovës dhe krijimin e mundësive më të lehta për intervenime në territorin e komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Agjensisë për Menaxhimin e Emërgjencave - AME, Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së GJKP dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

